



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.271/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Violeta Husaj Rugova kryesuese, Hajriz Hoti dhe Bujar Muzaqi anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e parashtruar nga Eroll Venhari nga subjekti politik Koalicioni për Familje me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Komisionit Komunal i Zgjedhjeve (KKZ) në Rahovec, lidhur me nominimet e anëtareve të Këshillave të Vendvotimeve, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 09.02.2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 03.02.2025, mori këtë:

V E N D I M

KONSTATOHET tërheqja e ankesës ankesa Anr.271/2025 e datës 31.01.2025, e parashtruar nga parashtruar nga Eroll Venhari nga subjekti politik Koalicioni për Familje me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Komisionit Komunal i Zgjedhjeve (KKZ) në Rahovec, lidhur me nominimet e anëtareve të Këshillave të Vendvotimeve, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 09.02.2025.

A r s y e t i m

Me datën 31.01.2025 PZAP ka pranuar një ankesë nga Eroll Venhari nga subjekti politik Koalicioni për Familje me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Komisionit Komunal të Zgjedhjeve (KKZ) në Rahovec, lidhur me nominimet e anëtarëve të Këshillave të Vendvotimeve në të cilën thekson se i nominuari i tyre Egzon Hamza është larguar nga lista e nominimeve të KVV me arsyetimin se i përket komunitetit jo shumicë ku me këtë rast KKZ-ja në Rahovec ka tejkualuar kompetencat ligjore dhe ka shkelur rregulloren e nominimeve për shkak se nuk ka prezantuar vendimin për largimin e anëtarit të KVV-se.

Me datën 01.02.2025 Eroll Venhari në njoftimin e tij përmes emailit të datës 01.02.2025, dërguar në PZAP ka theksuar se janë tejkualuar problemet dhe mosmarrëveshjet me KKZ në Rahovec ku anëtarit i tyre mbetet në KVV dhe janë sqaruar keqkuptimet mes tyre.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi kërkesën për tërheqjen e ankesës, në kuptim të nenit 11 paragrafi 8 i Rregullores nr.01/2024 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-së, si dhe nenit 115.1 të LZP -së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

A.nr.271/2025, datë 03.02.2025

Kryesuese e Panelit

Violeta Husaj Rugova

